



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER SOKOL SH. MALAJ
ADRESA NR.2, LUIGJ GURAKUQI
TEL: 684055554

VENDIM PËR LËSHIMIN E DËSHMISE SË TRASHËGIMISË LIGJORE

Nr. repertori: 2251

Nr. koleksioni: 881

Tirane më 28/12/2020

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Notarinë"



A2020050710084023388

*Akti noterial përbëhet nga 4 fletë



**LËSHIMI I DËSHMISË
SË TRASHËGIMISË LIGJORE
(Me heqje dore nga Trashëgimia)**

Sot, më datë 28 Dhjetor 2020 (dy mijë e njëzet) ditën e hënë, para meje Noter SOKOL SH. MALAJ, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën TIRANE, NR.2, LUIGJ GURAKUQI, u paraqit personalisht

KËRKUESE: Znj. ANYLA KASNECI e bija e Jorgo, dhe Kristina, shtetase Shqiptare, lindur në Gjirokaster më 22/05/1963 dhe banuese në TIRANË, me adresë Sulejman Delvina; Nd. 2; H. 23; Ap. 22; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5, 1019; Tiranë, gjendja civile “e ve”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 033883061 dhe nr. personal G35522107B, aktualisht përdoruese e telefonit 00355682074599.—

OBJEKTI I KËRKESËS: Lëshimi i dëshmisë së Trashëgimisë Ligjore për trashëgimlënësin, bashkëshortin e saj të ndjerin **ROBERT PILO KASNECI**.—

BAZA LIGJORE: Nenet 316, 317, 333, 318, 348, 360, 361 e vijues i ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet, neni 61, pika 1, shkronja d, j; nenet 97, 111, 112, 113 e vijues të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”.

Pasi administrova në tërësi provat shkresore të prezantuara nga kërkuesja dhe dëgjova pretendimet e saj, Unë Noteri kryesisht, bazuar në nenin 111, 113 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”, përpara shqyrtimit të bazueshmërisë në ligj e në prova të kërkesës, verifikova dhe konstatova se kjo çështje hyn në kompetencën e Shërbimit Noterial, të Degës Vendore Tiranë, përkatësisht Noter SOKOL SH. MALAJ, me zyrë Noterie në TIRANE, NR.2, Rr “LUIGJ GURAKUQI”, territor mbi të cilën shtrin kompetencën kjo zyrë për shqyrtimin e kësaj kërkesë. Në këto kushte,

VËREJ SE:

Nga kërkuesja, Znj. ANYLA KASNECI është depozituar në zyrën noteriale, një kërkesë me anë të së cilës kërkohet Lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë ligjore për të ndjerin, bashkëshortin e saj **ROBERT PILO KASNECI**.—

Nga çertifikata e vdekjes e lëshuar nga Zyra e Gjëndjes Civile Tiranë, Njësia Bashkiake nr.5 Tiranë e datës 10.12.2020, rezulton se më datë 23.11.2020 ka vdekur në Romë; Itali, bashkëshorti i kërkueses i ndjeri **ROBERT KASNECI** i biri i Pilo dhe Nermin lindur në Tiranë me 11.12.1953, banues në Tiranë, “Sulejman Delvina” Nd.2, H.23, Ap.22, fakt ky që vërtetohet me Çerfikatën e vdekjes të cituar më sipër.

Nga aktet rezulton se i ndjeri **ROBERT KASNECI** ka qenë i martuar me shtetasen ANYLA KASNECI dhe nga kjo martesë kanë patur një fëmijë, vajzën ANTEA KASNECI.

Sipas nenit 318 të K.Civil, trashëgimia çelet në kohën dhe vendin e vdekjes së trashëgimlënësit dhe përcaktimi i trashëgimtarëve do të bëhet sipas dispozitave të K.Civil të vitit 1994 i cili është në fuqi.



Kërkuesja legjitimohet në ngritjen e kësaj kërkese për shkak se është një nga trashëgimtarët ligjorë të të ndjerit, është bashkëshortja e tij.—

Gjithashtu konstatova se kërkesa e paraqitur plotëson kushtet e parashikuara prej nenit 46/ 1 i K.P.Civile lidhur me kompetencën vendore për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë, fakt ky që vërtetohet me çertifikatën e vdekjes të lëshuar nga Zyra e Gjëndjes Civile Njësia Bashkiake Nr 5 Tiranë e datës 10.12.2020.—

Në bazë të nenit 316 të K.Civil, me vdekjen e trashëgimlënësit lind marrëdhënia juridike e trashëgimisë dhe në këtë dispozitë saktësohet se “Trashëgimia është kalimi me ligj ose me testament i pasurisë (trashëgimit) të personit të vdekur, një ose më shumë personave (trashëgimtarë), sipas rregullave të caktuara në këtë Kod.”—

Veç kësaj koha e vdekjes së trashëgimlënësit është përcaktuese në lidhje me ligjin material që do të zbatohet për rregullimin e marrëdhënies juridike të trashëgimisë. Pra, trashëgimtarët dhe pjesët takuese të tyre do të përcaktohen nga ligji material në fuqi në kohën e vdekjes së trashëgimlënësit, si fakti juridik me të cilin lidhet marrëdhënia juridike e trashëgimisë.—

Nisur nga kriteret e përcaktuara në nenin 317 të Kodit Civil ku bëhet e qartë se “Trashëgimia me ligj zbatohet kur trashëgimlënësi nuk ka bërë testament, ose ka bërë vetëm për një pjesë të pasurisë së tij, ose kur testamenti është tërësisht ose pjesërisht i pavlefshëm”.—

Nga shpjegimet e kërkueses dhe nga verifikimi i bërë në Regjistrin e Dhomës Kombëtare të Noterëve e datës 24.12.2020, nuk rezulton që trashëgimlënësi të ketë lënë testament, prandaj do të zbatohet Lëshimi i Dëshmisë së Trashëgimisë Ligjore sipas Nenit 348 të K.Civil i ndryshuar me Ligjin nr 131 datës 13.05.2013 dhe neni 388 i K. Pr.Civile.

Me Vendimin për Lëshim të Dëshmisë së Trashëgimisë Ligjore me Nr.2185REP dhe Nr.857KOL e datës 16.12.2020, akt i hartuar/noterizuar nga Noter Sokol Sh. MALAJ, është bërë lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë dhe janë përcaktuar trashëgimtarët ligjorë të tij, bashkëshortja ANYLA KASNECI dhe vajza ANTEA KASNECI.

Sipas përcaktimeve që bëhen në Nenin 333 të K. Civil, nga vajza ANTEA KASNECI është kërkuar të heqë dorë nga e drejta e trashëgimisë.

Për këtë qëllim, **Znj. ANTEA KASNECI** me aktin noterial -Deklaratën Noteriale me Nr.2216REP dhe Nr.868KOL të datës 18.12.2020, ka hequr dorë në mënyrë të përvokueshme nga e drejta e trashëgimisë (për pjesën e saj takuese), që i vjen dhe që mund ti vijë me trashëgim nga babai i saj **ROBERT KASNECI**, si trashëgimtarë ligjorë e të ndjerit.

Kjo deklaratë është bërë me vullnetin e saj të lirë e të plotë në zyrën e Noterisë, në të cilën shprehet qartë dakordësia që kuota përkatëse e trashëgimtarës **Znj. ANTEA KASNECI**, në çdo pasuri të luajtshme apo të paluajtshme t'i kalojë në pronësi nënës së saj **Znj. ANYLA KASNECI**, dhe ajo të jetë trashëgimtarë e vetme ligjore e të ndjerit **ROBERT KASNECI**, deklaratë e bërë konform dispozitave të Kodit Civil, konkretisht neni 333 (ndryshuar me ligjin nr. 121/2013, neni 3) “Heqja dorë nga trashëgimia ligjore”.—

Edhe **Znj. ANYLA KASNECI**, ka deklaruar se është dakord me sa sipër, dhe se nuk ka asnjë pretendim apo mosmarrëveshje për këtë fakt.

Në këto rrethana, kur trashëgimtarja **ANTEA KASNECI** ka hequr dorë nga e drejta e trashëgimisë, trashëgimtarë ligjore e vetme e rrachës së parë e të ndjerit **ROBERT KASNECI** do të deklarohet bashkëshortja e tij **ANYLA KASNECI** e bija e Jorgo dhe Kristina lindur në Gjirokastër më 22.05.1963 banuese në Tiranë, “Sulejman Delvina”, Nd. 2; H. 23; Ap. 22, me Nr personal #G35522107B#, gjëndja



civile "e ve", fakt ky që vërtetohet me Çertifikatën personale të datës 26.12.2020 lëshuar dhe vulosur elektronikisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjëndjes Civile, Njësia Administrative Nr.5, Tiranë, e cila ka zotësi juridike për të trashëguar.—

Për përcaktimin e rrethit të trashëgimtarëve ligjorë të të ndjerit do t'i referohemi nenit 360 e vijuesa të K.Civil. Në mbështetje të nenit 361 të Kodit Civil, si trashëgimtarë ligjorë në rradhë të parë, thirren në trashëgim fëmijët dhe bashkëshorti i aftë ose i pa aftë për punë, të cilët trashëgojnë në pjesë të barabarta të gjitha të drejtat dhe detyrimet.—

Veç sa sipër, prej meje Noterit nuk konstatohet që ndonjë nga trashëgimtarët ligjorë të jetë shpallur i padenjë nga Gjykata të jetë përjashtuar nga trashëgimia por rezulton se në formën e kërkuar nga ligji njëri prej trashëgimtarëve ligjorë vajza ANTEA KASNECI të ketë hequr dorë nga trashëgimia në tërësi, veprim ky i parashikuar në Nenet 322-333 të K.Civil.—

Këto rrethana vërtetohen nga çertifikata e Tringut Familjar me Nr.serial 016751817 e datës 04.12.2020 lëshuar nga Zyra e Gjëndjes Civile (Arkiva) Bashkia Tiranë, Çertifikata familjare dhe çertifikatat personale të trashëgimtarëve ligjorë.—

Nga provat e administruara, nuk rezulton që trashëgimlënësi të ketë patur fëmijë të tjerë nga ndonjë martesë tjetër apo të ketë fëmijë jashtë martese ose të birësuar, rrethana këto të parashikuara nga neni 362 i K.Civil.—

Nuk rezulton që trashëgimlënësi të ketë përjashtuar nga trashëgimia trashëgimtarët ligjorë sipas nenit 378 të K.Civil.—

Veç kësaj nuk ekziston asnjë shkak padenjësie që i bën trashëgimtarët ligjorë të padenjë për të trashëguar.—

Në këto kushte nga unë Noteri çmohet që duhet të lëshohet dëshmia e Trashëgimisë ligjore dhe trashëgimtare ligjore e vetme e rradhës së parë e trashëgimlënësit **ROBERT PILO KASNECI** është bashkëshortja **ANYLA JORGO KASNECI** e cila trashëgon të gjithë pasurinë trashëgimore dhe të drejtat e detyrimet që rrjedhin nga çdo pasuri trashëgimore e trashëgimlënësit.—

Në rrethanat kur pasi është lëshuar Vendimi i trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin **ROBERT PILO KASNECI**, para heqjes dorë prej trashëgimisë dhe pas kësaj njëri prej trashëgimtarëve ligjorë, vajza e tij Znj.**ANTEA KASNECI** ka hequr dorë nga e drejta e trashëgimisë, vlerësoj se kërkesa është e drejtë dhe e mbështetur në ligj e në prova prandaj ajo duhet pranuar.—

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenet: 316, 317, 318, 320, 333, 348, 360 e vijues të Kodit Civil, dhe neni 61, pika 1, shkronja d, j; nenet 97, 111, 112, 113 e vijues të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për noterinë";

V E N D O S A

Pranimin e kërkesës. Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore me heqje dorë nga trashëgimia për trashëgimlënësin **ROBERT PILO KASNECI** duke përcaktuar si trashëgimtare ligjore me heqje dorë nga trashëgimia të vetme të rradhës së parë:

ANYLA JORGO KASNECI

Bashkëshortja

e cila trashëgon trashëgimlënësin **ROBERT PILO KASNECI**, në të gjithë pasurinë trashëgimore dhe të drejtat e detyrimet që rrjedhin nga çdo pasuri trashëgimore e trashëgimlënësit.—

Trashëgimtarja do të përgjigjet për të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo trashëgimi.

Kërkesja mori dijëni dhe iu sqarua nga Noteri detyrimi ligjor për depozitimin e dëshmisë së



trashëgimisë ligjore në institucionin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, brenda afatit ligjor prej 30 (tridhjetë ditë kalendarike), nga data e lëshimit të saj. Në rast të kundërt, për çdo ditë vonesë, aplikohen penalitete përkatëse sipas dispozitave ligjore në fuqi, referuar nenit 25, pika 2 e ligjit 111/2018 "Për Kadastrën".

Bashkëlidhur certifikata e martesës nr akti 2418, datë 24.11.1988 midis ROBERT KASNECI dhe ANYLA BULO (mbiemri pas martese KASNECI), lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile (Arkiva) Bashkia Tiranë, me Nr.serial 016309656 e datës 11.12.2020, referuar nenit 112, pika 3 e ligjit 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

Shpenzimet Noteriale i ngarkohen kërkueses.

Kjo dëshmi trashëgimie përbëhet nga 4 (katër) fletë dhe lëshohet në kopje origjinale nga të cilat, njëra depozitohet në arkivin e zyrës noteriale, nga një kopje i dorëzohet kërkueses për ta paraqitur në institucionet përkatëse (për aq pasuri sa disponon) dhe nga një kopje u jepet trashëgimtarëve ligjorë.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj dëshmie, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

Kundër këtij vendimi për lëshim dëshmi trashëgimie ligjore, mund të bëhet ankim në Gjykatën kompetente, sipas rregullave për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Dëshmia e trashëgimisë ligjore lëshohet në Tiranë, sot më datë 28.12.2020.

NOTER
SOKOL SH. MALAJ

NOTER. SOKOL SH. MALAJ
RR "LUIGJ GURAKUQI" P 2 TIRANË, ALBANIA
Tel: +355 4 222 98 32 / Cel: +355 68 40 5555 4
e-mail: kolimalaj@hotmail.de



TAKSA E PULLES
U PAGUA